



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr. 450 Prot.

Tiranë, më 26 . 05 .2021

URDHËR

Nr. 53 datë 26 . 05 .2021

**« PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR
PUNONJËS PRANË QENDRAVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE
PARËSORE »**

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” dhe Ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

URDHËROJ:

1. Miratimin e Metodologjisë së Vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore si dhe anekseve bashkëlidhur kësaj metodologjie si vijon :
 - Aneks nr. 1-Tabela e vlerësimit sipas dokumentave në dosjen vetjake;
 - Aneks nr. 2-Tabela e vlerësimit të performancës nga intervista me gojë;
 - Aneks nr. 3-Tabela e vlerësimit të pwtgijgjes sw pyetjeve nga intervista me shkrim;
 - Aneks nr. 4-Tabela e vlerësimit përfundimtar të kompetencës profesionale;
 - Aneks nr. 5-Vendim për caktimin e kandidatëve me rezultatet më larta.
2. Ngarkohet «Komisioni për zhvillimin e procesit të konkurimit për vende të lira pune dhe procedurat e konkurimit » për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys QIRICI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

**METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË KOMPETENCËS PROFESIONALE TË
PUNONJËSVE TË QENDRAVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE
PARËSORE**

Vlerësimi i kompetencës profesionale do të arrihet përmes vlerësimit të arritjeve në tre fusha:

- A. Vlerësimi i arsimimit, përvijës profesionale dhe trajnimet të dokumentuara në dosjen vetjake
- B. Vlerësimi i përgjigjeve të pyetjeve nga konkurimi me shkrim
- C. Vlerësimi i përgjigjeve të pyetjeve gjatë intervistës të strukturuar me gojë

Për secilën fushë, do të përdoret sistemi e mëposhtëm të treguesve dhe pikët për secilin prej tyre.

**A. Vlerësimi i arsimimit, përvijës profesionale dhe trajnimet të dokumentuara në dosjen
vetjake**

- 1) *Diplomimi* (15 pikë total)
 - a. Master Profesional (5 pikë)
 - b. Master Shkencor (10 pikë)
- 2) *Përvoja profesionale, eksperienva të mëparshme, kualifikime* (10 pikë total)
 - a. Vjetërsia në profesion (5 pikë)
 - b. Kualifikime kompjuteri (2 pikë)
 - c. Kualifikim Gjuhë e huaj (2 pikë)
 - d. Të tjera çertifikime (1 pikë)
- 3) *Të tjera arritje* (5 pikë total)
 - a. Krijime
 - b. Të tjera aftësi

B. Vlerësimi i përgjigjeve të pyetjeve nga konkurimi me shkrim

- 4) *Testimi me shkrim* (50 pikë total)
 - a. Testimi me shkrim do të përmbajë gjithësej 5 pyetje teorike dhe kazuse nga sferat ligjore dhe profesionale. Secila pyetje do të vlerësohet me maksimumin 10 pikë. Koha në dispozicion 30 min.

C. Vlerësimi i përgjigjeve të pyetjeve gjatë intervistës të strukturuar me gojë
(20 pikë total)

- 5) *Intervista e strukturuar me gojë*

- a. Misioni dhe vizioni, prioritetet dhe objektivat (10 pikë)
b. Vetëvlerësimi dhe motivimi (10 pikë)

Koha maksimale për secilin kandidat është 10 min.

Vlerësimi përfundimtar i kompetencës profesionale arrihet nëpërmjet rezultatit përfundimtar bazuar në treguesit e paraqitur në tabelë:

Emër Mbiemër	Vlerësimi i aritjeve të dokumentuara në dosjen vetjake	Vlerësimi i produkteve nga konkurimi me shkrim	Vlerësimi i performancës nga intervista me gojë	Totali pikë Deri 100 pikë
	Deri 30 pikë	Deri 50 pikë	Deri 20 pikë	

Kandidatët me vlerësim total më të ulët se 40 pikë nga 100 pikë të mundshme nuk bëhen pjesë e listës së kandidatëve fitues për pozicionin vakant.

Nëse për të njëjtën Qendër të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore shpallen 2 dhe më shumë vende vakante me të njëjtat detyra funksionale, kandidatët fitues do të jenë nga renditja e dy ose më shumë kandidatëve me pikët më të larta.

Bashkëlidhur metodologjisë gjenden:

- Aneks nr. 1-Tabela e vlerësimit të aritjeve të dokumentuara në dosjen vetjake;
- Aneks nr. 2-Tabela e vlerësimit të performancës nga intervista me gojë;
- Aneks nr. 3-Tabela e vlerësimit të performancës nga intervista me shkrim;
- Aneks nr. 4-Tabela e vlerësimit përfundimtar të kompetencës profesionale;
- Aneks nr. 5-Vendim për propozimin e kandidatëve me rezultatet më larta.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ERGYS QIRICI

